



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje** me **zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Pyetja	9	10	11	12	13	14	15	16a
Pikët								
Pyetja	16b	17	18	19	20	21	22	23
Pikët								
Pyetja	24	25	26	27	28	29	30a	30b
Pikët								
Pyetja	30c	31	32	33	34a	34b	34c	34d
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Pjesa I**AUTOBIOGRAFIA E POPULLIT NË VARGJE**

Dëshira për të shkruar diçka për poezinë popullore, më lindi ndoshta gjatë një nate fluturimi me avion mbi Arabinë Saudite, ndërsa po kthehesha nga Kina. Them “ndoshta”, sepse askush nuk mund ta dijë saktësisht se ku dhe kur lind dëshira për të shkruar diçka.

Ishte një natë e errët, fund tetori. Aeroplani ynë kishte dy-tri orë që ishte ngritur nga aeroporti i Karaçit dhe i duheshin akoma dy-tri orë për t'u ulur në aeroportin më të afërt, atë të Kajros. Dhjetë kilometra poshtë nesh, e ftohtë, e vdekur, nën një hënë si prej kauçuku, shtrihej shkretëtira arabike. S'kishte gjë më të pikëlluar se ajo zbrazëti rëre, sipër së cilës, pasqyrimi i hënës zhvendosej ngadalë si një sy pa jetë. Në këto çaste, si për t'u mbrojtur nga ulërima e vdekur e shkretëtirës, njeriu kërkon të kapet pas diçkaje: pas një libri, një mendimi, një fytyrë të dashur. Më kot stuardesat na jepnin kuverta për t'i vënë sipër gjunjëve. E ftohta e vërtetë vinte që nga poshtë, nga ai bosh, nga ajo mungesë mijëra kilometrash katrore. Por s'ishte vetëm kjo.

Kisha lexuar shumë libra dhe kisha lënë pas shumë njerëz të dashur, pamjen e të cilëve mund ta sillja ndër mend për të harruar shkretëtirën dhe ankthin. Mirëpo në ato çaste përhumbeje ndërgjegjja ime pranoi tjetër gjë: as libra e art, kujtime të afërmish, por diçka tjetër: një këngë. Ishte kënga e vjetër popullore e Urës së Qabesë. Mund të mendoja se ajo këngë e pikëlluar m'u kujtua sepse po fluturonim pikërisht mbi ato vise, ku ushtarët shqiptarë, që bënë shërbimin në rërat e Jemenit, e kishin krijuar atë piramidë:

*Mbeçë, more shokë, mbeçë
Përtej Urës së Qabesë.*

Mirëpo s'ishte krejtësisht ashtu. Unë nisa ta këndoj me vete këngën dhe, porsa e mbarova atë aty për aty me ngut, si njeriu që ka nevojë për oksigjen, nisa të këndoj një tjetër. Dhe kështu me radhë, gjersa afroi të gdhinte, kalova nëpër mend pothuajse krejt repertorin e këngëve popullore që dija. Larg, diku anash, kuqëlonte ftohtë mëngjesi kontinental aziatik. Poshtë ishte akoma shkretëtira, por unë isha tashmë i mbrojtur prej saj. Dhe, ashtu i lodhur siç isha nga ajo rrugë e ai shkretim, pa fjalë, pa formulime dhe estetikë, unë kuptova thjesht dhe natyrshëm se ç'fuqi kolosale kishte poezia popullore. Në atë zhveshje të frikshme të planetit, e vetmja ajo, ishte e aftë të dyzonte jetën, pyjet, ujërat dhe fjalët që mungonin. Ishte më shumë se art dhe më e nevojshme se një brez shpëtimi.

Marrë nga: “Autobiografia e popullit në vargje” I. Kadare
Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1980

1. Çfarë e nxiti autorin të mendojë për poezinë popullore? **1 pikë**
 - A) Një udhëtim nëpër natyrën e mrekullueshme të Arabisë Saudite.
 - B) Një fluturim mbi shkretëtirën arabe, duke u kthyer nga Kina.
 - C) Leximi i librave të vjetër dhe kujtimi i njerëzve të dashur.
 - D) Një ngjarje e papritur gjatë fluturimit.

2. Nisur nga teksti, poezia popullore është: **1 pikë**
 - A) një formë arti të cilën autorin e konsideron të panevojshme.
 - B) një shpëtim shpirtëror nga ndjenja e boshllëkut.
 - C) një mënyrë për të kaluar kohën gjatë fluturimi.
 - D) një mjet për të shprehur pikëllimin e autorit.

3. Detaji i jashtëm që ndikoi tek autori gjatë fluturimit, ishte: **1 pikë**
 - A) mjegulla e dendur mbi qytetet evropiane.
 - B) një shi i rrëmbyeshëm mbi oqean.
 - C) shkretëtira e errët dhe e ftohtë.
 - D) malet me borë të Afganistanit.

4. Krahاسimi “hëna si prej kauçuku” e ndihmon autorin që: **1 pikë**
 - A) të theksojë bukurinë natyrore.
 - B) të tregojë lodhjen nga udhëtimi.
 - C) të krijojë një atmosferë romantike.
 - D) të përforcojë gjendjen emocionale.

5. Çfarë ndodh me autorin gjatë përhumbjes së tij? **1 pikë**
 A) fillon të shkruajë poezi të reja.
 B) kujton një roman të sapo lexuar.
 C) i rikthehet në mendje një këngë popullore.
 D) i vijnë ndër mend fytyrat e njerëzve të dashur.
6. Autori filloi të këndonte disa këngë njëra pas tjetrës sepse: **1 pikë**
 A) po kërkonte frymëzim për një roman.
 B) këngët i jepnin qetësi shpirtërore.
 C) ia kërkuan udhëtarët e tjerë.
 D) kishte frikë nga fluturimi.
7. Cilës klasë i përket fjala *fund* në fjalinë: “*Natë e errët, fund tetori.*”? **1 pikë**
 A) emër.
 B) pjesëz.
 C) ndajfolje.
 D) parafjalë.
8. Qarkoni alternativën në të cilën nuk kemi emër të dygjinishëm. **1 pikë**
 A) pyjet.
 B) librat.
 C) ujërat.
 D) mëngjeset.
9. Mënyra e fjalëformimit të fjalës *i llahtarshëm*, është me: **1 pikë**
 A) nyjëzim.
 B) konversion.
 C) prapashtesim.
 D) nyjëzim dhe prapashtesim.
10. Fjala “*Ishte më shumë se art dhe më e nevojshme se një brez shpëtimi.*”, për nga mënyra e ndërtimit është: **1 pikë**
 A) e thjeshtë.
 B) e përbërë me bashkërenditje.
 C) e përbërë me nënrenditje ffilluese.
 D) e përbërë me nënrenditje krahasore.
11. Dalloni gjymtyrët homogjene në fjalinë e dhënë. “*Dhjetë kilometra poshtë nesh, e ftohtë, e vdekur, nën një hënë si prej kauçuku, shtrihej shkretëtira arabike.*” Përcaktoni funksionin e tyre sintaksor. **2 pikë**
 Gjymtyrët homogjene:
 Funksioni sintaksor:
12. Në fjalinë “*Ushtarët shqiptarë, që bënë shërbimin në rërat e Jemenit, e kishin krijuar atë piramidë*”, veçoni një përemër duke përcaktuar llojin e tij. **2 pikë**
 Përemri: Lloji:
13. Dalloni llojin e formës së pashtjelluar në fjalinë: “*Mund të sillja ndër mend shumë gjëra për të harruar shkretëtirën dhe ankthin.*” Cili është funksioni sintaksor që kryen në fjali? **2 pikë**
 Forma e pashtjelluar:
 Funksioni sintaksor:

14. Dalloni kohën e foljes që mbizotëron në paragrafin e dytë. Shpjegoni qëllimin e këtij përdorimi. **2 pikë**

Koha

Qëllimi:

15. Dalloni të paktën dy detaje të përshkrimeve atmosferike në rrëfim dhe shpjegoni rolin e tyre në krijimin e atmosferës. **3 pikë**

1.

2.

.....

16.
a) Cila është perspektiva e rrëfimit që përdoret në këtë tekst? Çfarë fiton teksti nga kjo perspektivë rrëfimi? **2 pikë**

.....

.....

- b) Rrëfimi ndërtohet mbi një kujtim të një udhëtimi të dikurshëm. Cili është roli i retrospektivës në këtë fragment? **1 pikë**

.....

17. Gjeni kontrastin në paragrafin e fundit dhe shpjegoni efektin që krijon ai. **2 pikë**

Kontrasti:

Efekti:

PJESA II

LASGUSH PORADECI

“Ku vemi shpesh” poezi nga vëllimi “Ylli i zemrës”

Në zemër t’ ende vetëm unë,
Në zemër t’ ime vetëm ti,
Dhe jashtë bota fjalëtare,
Dhe jashtë syri plot zili.

Dh’ ashtu filluam përngahera
Një vetësi plot ëmbëlsi,
Të mos na shohë syr’ i botës,
Mos na zemrosh, moj njerëzi.

Dhe ikm’ e ikmë gjith-më largë,
Dyke kërkuar pak liri,
Që me t’u ndezur flak’ e ditës,
Gjer më të mugëtiti të zi;

Gjer në mesnatë-e pasmesnatë,
Oh! e pangopur e arrati!
Un’ hijerënd’ e mvrerësuar,
Ti buzëndritur në stoli.

Nër ato male shtat-mëdhaja
Nër ata pyj me fshehtësi,
N’ ato mburima lozonjare,
N’ ata shkëmbinj plot llaftari;

Ku fryn një erë pastërtije,
E vetëtin një bukuri,
E rritet malli posi deti,
E ndizet zemëra në gji;

Ku nuku duket asnjëri,
Ku vemi shpesh veç un’ e ti
Ku djeg si zjarr, moj dashuri!
Ku ndrin si yll, moj perëndi!

- 18.** “Ku vemi shpesh” është lirikë: **1 pikë**
A) dashurie.
B) filozofike.
C) shoqërore.
D) meditative.
- 19.** Dy subjektet lirike të poezisë (*unë dhe ti*) shkojnë shpesh: **1 pikë**
A) pranë njerëzve.
B) në zemrën e tyre.
C) më afër fjalëtarëve.
D) pranë syrit të botës.
- 20.** Poeti e përshkruan dashurinë si ndjenjë që paragjykohet. Kjo ide duket qartë në vargun: **1 pikë**
A) Një vetësi plot ëmbëlsi.
B) Gjer më të mugëtit të zi.
C) Dhe jashtë bota fjalëtare.
D) Dh’ ashtu filluam përngahera.
- 21.** Është neologjizëm i krijuar nga Lasgushi: **1 pikë**
A) arrati.
B) ëmbëlsi.
C) fjalëtare.
D) fshehtësi.
- 22.** Atmosfera që krijohet në dy strofat e para është: **1 pikë**
A) gëzim dhe hare.
B) frikë dhe pasiguri
C) trishtim dhe pendesë.
D) ëmbëlsi dhe fshehtësi.
- 23.** Në vargu “*Një vetësi plot ëmbëlsi*”, poeti shpreh: **1 pikë**
A) zemërimin ndaj një mjedisi që nuk të kupton ndjenjat.
B) ankthin që kaplon dy të dashuruar në fazën e njohjes.
C) dëshirën e të dashuruarve për të qenë pranë njëri-tjetrit.
D) frikën ndaj zbulimit të ndjenjave të tyre nga të panjohurit.
- 24.** Motivi i ikjes në poezi shërben për të shprehur: **1 pikë**
A) frikën nga ndëshkimi.
B) udhëtimin dhe aventurat.
C) kërkimin e pasurisë materiale.
D) arratisjen shpirtërore dhe lirinë.
- 25.** Vargu i ndërtuar mbi figurën e *elipsës* është: **1 pikë**
A) E vetëtin një bukuri.
B) Dhe jashtë syri plot zili.
C) Të mos na shohë syr’ i botës.
D) Dhe ikm’ e ikmë gjith-më largë.
- 26.** Poeti shmang detajet fizike të vashës sepse: **1 pikë**
A) i intereson më shumë natyra.
B) nuk gjen fjalë ta përshkruajë si duhet.
C) përqendrohet te ndjenja që i shkakton.
D) dëshiron ta mbajë të fshehtë portretin e saj.

- 27.** Veçori e stilit të poetit që zbulohet në këtë poezi është: **1 pikë**
 A) muzikaliteti i vargut.
 B) përdorimi i vargut të lirë.
 C) analiza e gjendjes psikologjike.
 D) zhveshja e vargut nga figuracioni.
- 28.** Gjeni në strofën e katërt një detaj që karakterizon secilin nga të dashuruarit. **2 pikë**

- 29.** Identifikoni dy fjalë, tipike të fjalorit lasgushian, në këtë poezi. **2 pikë**

- 30.**
 a) Në ç' mjedis e gjejnë lirinë e përjetimit të dashurisë, dy subjektet lirike? Ilustroni idenë tuaj me vargje nga poezia. **2 pikë**
 Mjedi:
 Ilustrimi:
- b) Përse dy të dashuruarit zgjedhin një mjedis tjetër, të ndryshëm nga ai në të cilin jetojnë? **2 pikë**

- c) Cili mjet stilistik përftohet nga përballja mes dy mjedisëve: atij në të cilin jetojnë dhe atij ku shijojnë lirshëm ndjenjat e tyre? **1 pikë**
figura letrare/ mjeti stilistik i përfutur
- 31.** Në poezi intensiteti i ndjenjës vjen në rritje. Gjeni tri vargjet ku jepet ky shkallëzim i ndjenjës. **3 pikë**

- 32.** Shpjegoni idenë e poetit për dashurinë të shprehur në dy vargjet e fundit të poezisë. **2 pikë**

- 33.** Interpretoni domethënien e kontrastit në vargun: "Un' hijerënd' e mvrerësuar, / Ti buzëndritur në stoli." **2 pikë**

PJESA III

- 34.** Në përditshmëri, secili prej nesh krijon kujtime që ndërtojnë ura të padukshme mes së shkuarës dhe të tashmes. Në fragmentin e shkëputur nga “Autobiografi e popullit në vargje”, kujtesa shfaqet si një përvojë e gjallë, që ndikon jo vetëm në mënyrën si e kujtojmë të shkuarën, por edhe në mënyrën si e kuptojmë të tashmen dhe ndërtojmë të ardhmen.

Nisur nga përvoja juaj, argumentoni pse kujtimet janë të rëndësishme si urë lidhëse mes së shkuarës dhe të tashmes dhe si ndihmojnë ato në krijimin e vizionit për të ardhmen.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (34a)	Organizimi dhe struktura (34b)	Stili dhe originaliteti (34c)	Saktësia gjuhësore (34d)	Totali 34
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

